

VENDIM
Nr. 745, datë 23.11.2022

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË TË BUXHETIT TË SHTETIT, TË
MIRATUAR PËR VITIN 2022, PËR DHËNIEN E KONTRIBUTIT FINANCIAR
NGA KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR
MBËSHTETJEN E FONDIT GLOBAL PËR ANGAZHIMIN DHE
QËNDRUESHMËRINË NË KOMUNITET (GCERF) PËR PARANDALIMIN E
EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit rezervë të buxhetit të shtetit, të miratuar për vitin 2022, për dhënien e kontributit financiar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, për mbështetjen e Fondit Global për Angazhimin dhe Qëndrueshmërinë në Komunitet (GCERF) në misionin e tij për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, në shumën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) euro.

2. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, në programin buxhetor “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, i shtohet shuma prej 7 200 000 (shtatë milionë e dyqind mijë) lekësh.

3. Efekti financiar, sipas pikës 2, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, miratuar për vitin 2022.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku